

HALIL BUÇPAPAJ

GURRAT E RUDINAVE

BIBLIOTEKA
SHTETIT

844-1

B 88

POEZI



814-1
1388

HALIL BUÇPAPAJ

GURRAT E RUDINAVE

poezi



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

P O V I J

Ja ku po vij rrugës së poezisë.

Shekulli paska hapur shtigje mes thepash
e mes tyre

po vij

te ju,

te këngë e gjallë e popullit,

te përjetësia e mendimit të drejtë.

Po vij,

dhe shoh se s'qenka kopsht me tulipanë

as kaçubishte me trërdafila e dashuriçka.

Po vij,

përmes hapave të revolucionit tonë

i djersitur

dhe i qeshur.

(Po të mos ishte poezia tambur i revolucionit,

dijeni, se njëqind herë poet të më urdhëronin të
bëhesha,

veç një varg do të shkruaja i peshuar:

«Të përshëndes, o i madhi revolucion!»
Po vij,
ndaj barrë të rënda ngarkomëni!

Shqipëria, vëllezër, ndërton pranverën!
Në kurrizin e maleve leqojnë rrugët e lumturisë.
Mbi to rendin karvanet e bollëkut të dritës,
rrjedhin tufat e pafund të gëzimeve të punës.
Nëpër to po vij
i kujdesur që ngjyrat të buçasin sa më furishëm
në poezi.
Në vërtikun e ngjitjes frymëmarrja e atdheut
është e nxehtë,
mushkritë e tij shkrijnë çelik e bakër të pavarësisë
së plotë.
Në damarët e tij shoh të rendë vrulli i skuqur i
ditëve të mbushura me punë.

E tek vij,
gjoksin duhet ta mbush plot ajër të pastër
që të rend i shpejtuar
bashkë me ju.

Në shekullin tonë
lëndinat e lulëzuara i mbjellim me kazmë,
i rrisim me tyta të mbushura barot,
që shpirti të pushojë në aromën e punës
e kënga të tingëllojë në hapsirat e lirisë.

Shqipëria,

vëllezër,

ndërton pranverën e vet!

Horizontet janë ngarkuar plot me re
e koha përherë buçet.

Po vij,

i gatshëm të marr rrugën më të përfillshme për
kohën tonë.

Po vij,

dhe më pëlqen

të ma shkruani emrin atje ku lumenjtë kapërdihen
e derdhen në dritë,

të apelohe me bashkë me punëtorët.

Ngulmani çadrën me barinj të e bjeshkëve të mia,
të jem mes blegërimave të bardha;

le të shetis në hapsirat detare,

si detarët e mi të pashoq, —

vargjet t'i ngjyros me det

e mendimin me guxim e trimëri,

të di t'i hap hapësirat e frymëmarrjes.

Baltën e fshatit dhe çizmet i kam me vete në
rrugën time,

(s'do të lejoj të m'i përbuzin qoftë dhe një thë-
rrime);

bujk i mirë jam e kam për të qënë

poshtë e lart fushës me vargje do të rend.

Po vij vëllezër,
mes jush.
Një gjak kemi
e të një betimi jemi.

Shqipëria
pranverën e vet ndërton mes një oqeani,
që fryn bulshitë e globit me dallgë pabesie.
Ndaj topat gati t'i kemi
e në luftë,
me kalibrat gjithnjë në rritje, të vemi.

Çdo varg të sjellë
skalion ushtarësh
trima e të bindur
në shërbim të revolucionit.

S'është koha për vargje të pudrosur,
që kilometra larg lëshojnë erë puthje,
Shqipëria, vëllezër,
pranverës shpatullat i ka vënë,
ndaj të ftohet s'do ta lëmë
as sot
as nesër.

N Ë F I E R Z Ë

Këtu lindin mëngjezet e spërkatur me borë e
djersë,

pikojnë çatitë pika shiu e bulëza drite.

Këtu gurët goditen e thërrmohen në dritë, —

tërë dritat pikojnë shpresa e ëndërra dritash

më të mëdha.

Këtu valët vërviten mes horizonteve të punës

e zvargen, e zbuten, e hidhen në kreshta

plot shkumë.

Këtu mbrëmja mbjell njëmijë e një buzëqeshje

ëndërrore

e buzëqeshjet shpërthejnë si gonxhe në drita.

Këtu dritat rriten e qeshin pa kufi,

dritat pjellin drita, puna punë e

kënga këngë.

Këtu ka kaltërsi ujërash e kthjelltësi

mendimi.

DËSHIRA E BUJKUT

Fusha e begatë qenka dëshira e bujkut e ngrohur
në diej shprese;
rrushi i vjelur qenka shkëlqimi i syve në notimet
e bardha të bollëkut;
kënga e bujkut qenka mushti i të gjithë verave
mbledhur në kupat e dëshirave të bardha,
gëzimi i tij qenka zgjerim i gjinjve të arave nga
bollëku e nga djersa.
Urimi për tokën nga gojë e bujkut del butë e
ëmbël
e njëqind herë në mjaltë ngjyhet e njëqind herë
në dëshirë tretet,
gjersa në tokën e begatë në pika djersa mbështetet.
Të shtyjë me bërryla kallinj të rëndë është dëshira
e kulluar e bujkut;
të mbajë mbi supe peshën e gjallesave të arave
është ëndërra më e ndershme pas punës në arë.

Në mos shkroftsh për misrin e grurin, për bollëkun
e plehtrat në arë,
bujkut s'i vjen mirë e në sy s'ka për të parë,
vështrimi i tij do të thotë njëqind herë:
«Komunizmi pa pjellësi arash s'vjen, or' i mjerë!»
E tërë jeta e tij poezi më derdh në penë.

Ç'M'I MORI MALLI

Ç'm'i mori malli delet për rudina!
Ç'm'i mori malli vargjet për stane!

Në këmborën e ogiçit i ngjita fjalët e vargjeve
e në to u reshën tingujt e pyllit e jehonat e bjesh-
këve.

Fyell' i bariut curril ndjenjash të vluara
u thye në meloditë më të buta se rudinat plot lule,
pastaj u var mbi pragun e stanit si një ëndërr e
vjetër
e moçmërisht tek rrasat e Bujës është mbështetur.

Tingulli i fjalës pyllin preku gjeth më gjeth
e vrimë më vrimë fyellit rrëshqiti
e vijë më vijë gishtat e bariut preku
e cep më cep remat e zemrës në ndjenja i ndezi, —
stanet zgjeruan brinjët e qeshën me bulshitë e
murrme.

Tërë ditën tufa e kooperativës rudinave kulloti
e vargjet u rritën, u bënë të brumshme,
të këndshme e të pastra si pihamë¹⁾ e flladit buzë
një kroi.

Ç'm'i mori malli delet për rudina!
Ç'm'i mori malli vargjet për stane!

1) pihamë — lëkundje.

K O S T A R È T

Në fshatin tim livadhet rrijnë me bark prej diellit
e mbi barkun e livadheve bari tallet me erën:
herë tundet andej e herë këndej në valëza të
gjelbra
e pastaj ngre kokën e rri si i burrëruar.

Kostarët pastaj tallen me barin,
(kostarët tanë të rritshëm e gojëtarë)
hapin krahët, e bari kujton se po rroken
veç kur bie e puth tokën.

Kostarët haparaven prapë me kosë
e bari këqyr diellin si i çuditur.

Tërë lulet që ka livadhi dihatin të këputura.
Tërë aroma e tyre ose struket akoma ose hapet
në ajrin e verës sonë.

Ë kostarët thithin nga kjo erë e mirë e tokës së
vet

e bëhen më të fortë, ndërsa djersa rrëshqet.
Në fshatin tim livadhet rrinë me bark prej diellit
e mbi barkun e livadheve bari përshëndetet me
tokën.

Barinjtë duan sa më shumë bar të prerë
e kostarët haparaven tërë ditën duke prerë.

MES DASHURISË

Ishte një kopsht plot lule e ngjyra i zhytur në
dritë,
ishte një këngë që ndërsente të gjitha fjalët për
t'u ëmbëlsuar,
ishte një fjalë që gurit i pëshpëriste dhe e bënte
muhabetqar,
ishte një rrugë e rrahur nga të gjithë e krejt e
virgjër rrinte!

Isha në njëmijë gosti bujqish i ftuar,
isha në njëmijë parada festive i zhytur,
isha në njëmijë tufa dëshirash të bashkëkohësve,
isha në njëmijë kërkime këmbëngulëse të popullit
tim.

Zemra më tha,
trupit më tha,
gjithshka më tha.
E kuptova, —
isha
mes dashurisë.

B A R E S H A

E pashë buzëqeshjen e saj të thërmojë ftohtësinë
e bjeshkës
dhe ftohtësinë e bjeshkës të largohet nga buzët
e saj,
e pashë vështrimin e saj nëpër kaltërsitë e qiellit
dhe kaltërsitë e qiellit të mblidhen në sytë e saj.

Baresha shkeli gjethet e ahut,
gjethet e ahut peshuan në tokën e bjeshkës,
toka e bjeshkës rriti dashurinë e djalit
e dashuria e djalit njomështoi buzëqeshjen e
bareshës.

Bora e bjeshkëve e bardhë si dashuria, —
dashuria e bardhë shkriu borën e bjeshkëve
e rudinave shetit vaktësia.

Baresha ngjitet nëpër rudina
eh, ç'tufë të bukur ka kooperativa!
E grigja mbledh lulet e rudinës
ndërsa baresha rrit dashurinë më të re të stinës.

BARDHËSI

Për fëmijët që mban ti, tezja ime F.B.

E marrim diellin në grykse
dhe e çojmë në çerdhe.


Cicërima e tyre — cicërima jonë e bardhë,
valë e ngrohtë që çel lulet e gëzimit.

Teto Fatimeja përkund ëndrrat e kaltra,
nën qepalla flejnë themelet e ditëve të bardha.

Nëpër doçkat e bardha, të buta, të vogla
çelsa, pulte, tastjera, kazma e vjersha fshihen.

Para tyre lartohet tërë bota,
vepra gjigande të së ardhmes ngrihen.

E marrim diellin nga çerdhja
dhe e sjellim në shtëpi.



BJESHKËT NË AUDITOR

Ç'u nis orteku me borë e gurë plot furi,
pisha e ahe duke shkukur si i tërbuar,
tej oshtima rreh shpate e shkëmbenj gri, —
gjithë duhia në auditor është futur.

Valbona rreh shkëmbin e mbi të hidhet,
puth brigjet e bardha e gudulis zallishtet:
me oshtimë ujvarash poezinë ma stërpik
e në fletoren e leksionit nis një këngë të tiskhtë¹⁾.
Piskama e çobanit vjen nga majë e thepit,
faqe më faqe shkëmbit duke i rënë,
dhe përzjehet në auditor me parimin e Dalamberit
e prap e fortë niset për në bjeshkë.
Ç'u reshën këto bjeshkë me degë pishash mbi mua
një këngë të re duke bulëzuar në auditor!

1) e tiskhtë — me zë të hollë e të lartë.

GOZHDA E VJETËR

Në atë gozhdë të ndryshkur e të gërryer kohësh
vdekjet dhe jetët u varën njëherësh
me krisma të kobshme e heshtje kërcënuese.

Në gozhdën e vjetër, barkuar nga pushka e rëndë,
u varën përshëndetjet e dasmave dhe flamuri,
lindjet e djemve dhe të trimërive këngë
mes shkrepimave që gëzimet e rralla ruanin.

Para hukamës së frengjisë potereshë,
tek ajo gozhdë,
u vu pushka pas pushkës
si nder pas nderit,
si jetë para jetës.

Aty u nisën shpatave, lugjeve e majave
dhe u varën mbi ne
ditët e hareshë.

Në atë gozhdë u varën pushkët
dhe ditët ruajtën njera tjetrën.

Atë gozhdë, tha baca,
ne nipat ta çonim në muze.

Gozhdën e vjetër në muze do ta vëmë
e pushkët larg vetes kurrë s'do t'i lëmë!

ASIM VOKSHIT

Në sytë e tu mbeti dielli i së nesërmes në rrezatim
e dy degë dashurie në fëshfërimë.

Në sytë e tu mbeti qielli i Spanjës tërë barot e tym
e dy sytë e nënës, — më i afërta bekim.

Në sytë e tu mbeti Kosova
e dy shpresa të ëmbla për ditë më të mira.

Në sytë e tu mbetën brigadat e kuqe
e dy këngë vullnetarësh të sapokënduara.

Në sytë e tu mbeti tërë vegjëlja e globit
e dy sytë e shqipes në majë të

Shkëlzenit.

KU ËSHTË PRANVERA

Një lule tha është në petalet e mia,
një zog tha është në cicërimën time,
fusha tha është në gjallërinë time,
pylli tha është në gjelbërimin tim,
kënga tha është në tingujt e mi.
E dashura tha e kam ndër sy.
Unë thashë e kam në vargjet e mia
... pranverën.

Mbi grunishtat e fshatit, ballëlarë, ngrohej
hëna;
në sytë e njerëzve shëtiste pranvera.

BJESHKA IME KUFITARE

Trokuzi është bjeshka ime kufitare, —
toka ime e parë, toka ime e mbrame.
Atje rriten këngët të gëzuara, si vajzat mes prillit,
njerëzit qeshin të hapur fytyre si bjeshkët në
lindje të diellit.
Te Kungji i Halilit ngren kokën piramida e bar-
dhë, —
dy botë i ndan.

Përrenjt rrjedhin të ftohur bornajave të verës,
njerëzit i falen Partisë e i mbahen besës;

rudinat rrinë të veshura me boronicë,
njerëzit rrinë me syrin pishë.

Trokuzi është bjeshka ime kufitare, —
toka ime e parë, toka ime e mbrame.

Në bjeshkën time varret e të parëve në një kodër
rrinë, —
me valëza bari e lulesh përshëndesin lirinë.

Ahishteve të gjera rriten vargjet me aromat e
lules,
horizontet i përshëndesim duke puthur grykën e
pushkës;
e dashura ime atje faqet i mban ndezur,
mes punës poezia rrjedh.

Trokuzi është bjeshka ime kufitare, —
toka ime e parë, toka ime e mbrame.

BISEDA E SHPATEVE

I

Mote të molisur ranë mbi mua
e brinjët e mia u terën e u gërryen.
Unë mbeta shpati i hukatjes së dimrave
njëqind herë i lëpirë prej ortiqesh të bardhë.

Jam shpati me brinjë të dalur motesh,
i shterur dëshirash për pak gjelbërim,
pak jetë,
pak dashuri për njerëzit e mi.

Fryjnë erërat e ngarkuara me mërzi
e mbi mua zbresin barrët e reja të pikëllimit.
Ah, sikur të kisha veç një gjeth të ri!
Ah, sikur të kisha veç një gem gjallimi!

II

Mote të përgjakur ranë mbi mua
e brinjët e mia u lyen me gjak.
Unë u bëra shpati i betejave
njëqind herë i kuqëluar prej gjoksesh të nxehtë.

Jam shpati me brinjë të thyera plumbash,
i mpakur dëshirash për pak gjelbërim,
pak jetë,
pak dashuri për njerëzit e mi.

Fryjnë e fryjnë erërat e ngarkuara barot,
balli më digjet në shtëllungënaja lufte.
E prap jam shpati që digjem në barot
e për jetën kam njëqind dëshira e lutje.

Ah, sikur të kisha veç një gjeth të ri!
Ah, sikur të kisha veç një gem gjallimi!

III

Motet e jetës ranë mbi mua
e gjallësia filloi të shtatnohet brinjëve të mia.
E shpina ime zuri tërë hapësirat
me kënaqësinë për pranverën, për gjelbërimin.

Fryjnë erëra të ngarkuara me shpresa
e sythet mbi mua çelin gjithnjë të rinj.

Mbi mua u ngulën lapidarët
me rrënjë në gjakun e luftës, në shpirtin e flijimit,
e unë, shpati i gjelbëruar, marr frymë i përmallur
e sytheve të rinj u them se mbi gjak rriten.

Fryjnë erëra të ngarkuara me valë shumëfarshe,
gë sjellin dritën e Partisë e gjallesa rritet,
unë bëhem më i fortë e gjoksi më buçet në dashuri.

Mijra valë dushojnë helm të pudrosur,
rasat tragjedish fabrikuar në botën borgjeze,
por, njerëz jini të vendosur
e rasatin të zërë rrënjë mos e lini asnjëherë!

Fryjnë erërat e brendëshme të vakta
gjallesat mbi mua rriten e shumohen.
O gjallesat e mia, njerëz të ndershëm
mbani mend se tërë dimrat erërat të ftohta
lëshojnë!

Unë shpati i rinuar nën thinja motesh
lakmi e të tjerëve për të kruar brirët mbetem
veç mbi krahët e miliona forcash, e miliona
hovesht,
në flakada ndriçues për botën
ndizem!

BJESHKËVE TONA

I vë buzët në gurrën e Rudinës, —
oh, ç'puthje e ëmbël, ç'mallëngjim, ç'dashuri!
Vështrimi i ëmbël i pishës
më ngroh, më kënaq e më jep fuqi!

Gjithë gurrat e bjeshkëve t'i pijmë
se shpatinave të blerta ku kullon dëbora
kemi këngën, kemi trimërinë!

D A S M A

Festës së dritave

Një burrë shtatvigan me zemër të bardhë,
duke ulur një çelës, u duk sikur hoqi duvakun:
kulla e vjetër në dritë u zbardh
ndërsa kandili u shemb përtej praktik.
Tupani nuk meket por «dum-dum», e me hare,
me krismat e pushkës përcillet një: «he-hej!».
Ndërsa drita i jep kullës puthje dashurie,
errësira e shekujve trishtueshëm ikën tej.

P A R T I A

Nga të gjithë mëngjezet
më i kthjellti,
më i qarti,
më i gëzuari, —

Partia.

Nga të gjitha fjalët
më e thjeshta,
më e sigurta,
më e ndershmja, —

Partia.

Nga të gjithë mendimet
më i shtruar, —
më i ploti,
më i zjarri, —

Partia.

Nga të gjithë vështrimet
më i mprehti,
më i dashuri,
më i rrepti, —

Partia.

Nga të gjitha këngët
më e freskëta,
më e gëzuara,
më e kapshmja, —
Partia.

Për të gjitha situatat
më e qeta,
më e guximshmja,
më largpamësja, —
Partia.

SHKRUAJA LETRËN VËLLAIT

Ia kushtoj Shpendit, vëllait tim.

Shkruaja letrën vëllait
e gëzimin e syve radhite mbi fletët e bardha.
Shkruaja letrën vëllait,
vërshimin e gjakut lëshoje nëpër fjalët e zemrës.
Shkruaja letrën vëllait
e ëmbëlsinë e ndjenjës ngjitja nëpër gërma.
Shkruaja letrën vëllait
ta ndjesh më pranë, të prekësh dashurinë e tij,
të mbash kullotat e bjeshkëve pranë vetes të
lulëzuara
e nëpër tufalakët e borigave të mbledhësh njëmijë
e një poezi.

Shkruaja letrën vëllait
të ndjejë përçafimin tënd, përçafimin e bjeshkëve
të veta
të bjerë mbi të tek sheshi «Skënderbej».
Shkruaja letrën vëllait
e gëzimin e syve dërgoje tek gëzimi i syve.

NË SYTË E MI U NDEZËT

Nxënësve të mi, 1973

Vogëlushët e mi të klasës së pestë,
natyra ç'hodhi mbi ju lule tërë ngjyra!
Vogëlushë, në sytë e mi u ndezët
nga gazi e shëndeti që ju rrjedh ndër fytyra.
Bubulak në zemër më ndizni zjarrin e gëzimit.
Fëmijë të mirë të fshatarëve të mi,
ja tek vini në orën e mësimit,
kujtime të ëmbla ndillni me mijë.

Vogëlushët e mi të klasës së pestë,
vit më vit do veni duke mësuar
e në gjakun tuaj ka për të mbetë
lëng i arave me ndjenjë të kulluar.

Vogëlushët e mi, fëmijët e bashkëfshatarve,
trima të rinj, gjak i të parve,
penën mbajmë, sulmojmë shkencë e dituri,
këngë, kazmë e pushkë kemi për Shqipëri.

P R E K Ë M

«Po të isha toka shqiptare çfarë do të
më thoshe!»

Iu përgjigja:

Prekma zemrën time e do të të digjet dora, —
bubulak digjet zjarri i dashurisë sime.

Prekma zemrën time e do të ndjesh të rrotullohet
bota

më e shpejtë se gjithnjë, me më shumë gëzime.

Prekma ballin tim dhe shiko qiejt si hapen
e në njëmijë ngjyra lumturia shpaloset.

(Poezisë i vëmë të kuqen, qiejve të kaltrën,
me tërë ngjyrat e ylberit e mbulojmë tokën).

Prekmë ndjenjat e mia që rrëshqasin të lira
e do ndjesh në gjoks të hapet dera e besnikërisë.

Nëpër ditë do të futen rreze përherë më të mira
e mbi qepalla vështrimet do të rrijnë mbështetur
në siguri.

Prekma zemrën time e do ndizet fjala jote, —
në afshin e shpirtit të ndezur, në zjarrin e tij,
do të ndjesh një kuptim fatlum të kësaj bote
e gëzimet do renditen me mijë.

DUKE SHKRUAR

nënës

Në dhomën time jam duke shkruar,
nëna e shqetësuar vjen e më trazon:
«U trete, biro, duke shkruar, —
të keqen nëna, pse nuk pushon?!»

Nënë e dashur, sa herë në arë
djersën ke derdhur e lodhur je, —
vetes «pusho!» a i the vallë
e bereqetin ndër ara e le?

Dhe doli nëna buzën kafshuar.
Mendoj e mira nënë e habitur:
«A thua vallë edhe duke shkruar
ditkan djemt bereqetin të rritin!»

Në dhomën time jam duke shkruar.
Ec, nënë, serbes, — mua s'më trazon!
Qumështi yt e i Partisë është bashkuar
e prej tij poezia gurrton.

N È P È R A R A

Nëpër ara hapim brazdat dhe hedhim farën;
thërrasim ditët e ardhshme dhe thurim këngën.

Nëpër ara endim bisedat tona të dlira,
mbledhim bollëkun dhe i çmojmë vajzat e mira.

Nëpër ara presim vërshimin e gëzimit të ditëve,
këndojmë këngë dhe shijojmë ngjyrat e stinëve.

Nëpër ara derdhim djersën si lumë,
e ndjejmë pse tokën e duam kaq shumë.

Nëpër ara rendim në baltë e cingërimë,
jetës i njohim ngjyrat e në të gjejmë poezinë.

FËMIJNIA IME

Fëmijnia ime —
burim i freskët ëndrrash të bardha
si ujrat e gurrave
nën qerpikët e ahishteve të gjera,
ninullë e ëmbël
nëpër lulet erëmira të rudinave.

Fëmijnia ime —
turri i pafrikësuar i fantazisë krenare,
që ngjit majat e trimërisë së kreshnikëve
dhe këndon si zogjt e bjeshkëve.

Fëmijnia ime —
pritja në majë të bjeshkës,
që lan sytë me rrezet e para dhe ujin e gurrave
dhe shpatinave njëh të gjithë emrat e luleve.

Fëmijnia ime —
emra vendesh të zgjuara me oshtimat e luftrave të
të parëve,

një piramidë e bardhë që s'len botën me u përzie
në bjeshkën time kufitare.

Fëmijnia ime —

borxhi i pashlyer i puthjeve të ëmbla
me opinga veshur nëpër bjeshkë,
mendimi i lidhur me dejet e gjakut të malësorit.

Në fëmijninë time

qingjat më ngjajnë të butë si fjalët e mixhës.
që më ndillnin në logun e ditëve.
(e tani po e përtrij në këngë)

Fëmijnia ime —

qenka rrëzuar nëpër vite duke lyer ballin me
rrudha,
duke sosur etjen kureshtare.
Flaka e syve paska mbetur po ajo
dhe dashuria e zemrës i përqafton njerëzit plot
çiltërsi.

Fëmijnia ime —

kristal i dashurisë për Partinë e vendin tim.
E prap,
si në fëmijëri,
rend prapa malit duke kënduar për ta.

S O C I A L I Z M I

Socializmi nuk është gosti
ku njerëzit të rrisin dhjamin —
kështu thanë gjeologët e bjeshkëve të mia.

Socializmi nuk është paradë
ku njerëzit të shohin dehjet euforike —
kështu thanë të rinjtë e fshatit tim.

Socializmi është furia e zemrave që derdhet në
beteja e ngren fitore,
ku çelin ditët e djersës e të këngës me mijëra
gonxhe gëzimesh —
kështu thanë njerëzit e mirë të kombit tim.

Socializmi qenka dielli i shpresave që ndizen në
tërë ngjyrat e jetës,

qenka fytyra e djersitur e minatorit që puth
vogëlushët gazplotë,
qenka kurora e artë që brezat i vunë vendit tim,
qenka gjithçka që kemi dashur e rritur në zemrat
tona,
qenka ajo që rrit hovet në përtejkufijt' e
mendimit,
qenka burimi i pastërtisë së ditëve —
kështu tha hovi i vendit tim.

PËR SHOKËT QË SHTRUAN SOFRËN E AGIMEVE

... Brigadat partizane u hodhën në tokat e Jugosllavisë për çlirimin e tyre. Reaksioni po tërhiqej përtej kufirit. Malësorët e Tropojës, të rinj e të moshuar, që nuk merrnin pjesë në brigada, u dolën përballë tradhëtarëve...

(Nga tregimet e luftëtarëve)

Retë e zeza u ndalën mbi Majën e Kores.

Valbona u mrrrol e u nxi.

Ç'janë ato vija të lëvizëshme që qafat e maleve
presin

e nxijnë në malësi?

Tradhëtia tërhiqet në rrugët e anëshme të largimit,
e friksuar zgërdhohet me plagët e tokës sonë.

Ndërsa ne po hidhnim, pa ndalur, hapin,

shpresën me fitoren,

nëpër plagët tona erdhën të na lëshojnë

rasatin e tradhëtisë.

Dëshmorët me buzë të rreshkura pëshpërisnin:

«Kujdes!»

*

* *

Arveja¹⁾ është kallë në barot e digjet në flakë lufte,
tradhëtinë ia damkosin vetes në ballë e gishtrinj.

Valbonë! Arveja ime! Shqipëri!

Lokja gjakun na e dha që ta skurrojmë për ju,
djepin na e gatitën me drurët e këtyre pyjeve
andaj këtu

vdekja të na përkundë

se në vatrën tonë po ndezim zjarrin e shpirtit!

*

* *

Krahërorin e tokës e përgjakëm —
më të rëndë e bëmë, më fisnike.

Shokët duke shtruar sofrën e agimeve të bardha
në flamur kanë ngjitur çiltërsinë e zemrave.

Shokët shtruan sofrën e agimeve
e ne po korrim bollëkun që rritëm mbi këtë tokë.
Gjaku i tyre mbeti burim i diellit të mendimit,
zemra e tyre burim i pashtershëm i këngëve tona.

1) Arveja = emër vendi në Tropojë ku u zhvillua lufta kundër tradhëtarëve.

Këndojmë këngë e ngjitemi nëpër pragje të reja.
Nëpër buzë kemi buzëqeshjen,
në shpatulla peshën e kohës.

Gjersa duart të na punojnë e të na rrahë zemra,
pa na u dridhë buza,
fli do të bëhemi për tokën tonë
e kohën e re!

I P A N G O P U R

Po lë peng vështrimin, Valbonë,
veç në sofrën tënde më le të rri shtruar!
I pangopur mbetem me bukuritë e tua
andaj shkruaj,
prapë shkruaj
e prapë mbetem udhëtar që fundin s'ia gjej
bukurisë.

E prap unë i unshmi¹⁾ i bukurive tua,
mbi zallin tënd
dehem në bukuritë tua,
të shpirtit të njerëzve,
të arave që vadisin kaltërsitë tua.

Kapem me jonet.
Në kaçurrelat e natës përplasen furitë e botës.

1) i unshmi = i uritur, që ka uri.

Bota ka dhëmbje.
Bota qesh.
Bota ngërdheshet
me jonet e ngacmuara prej mijëra antenash
llafazane.

Dhe unë kam rënë këmbëkryq në sofrën tënde
(ua mbylla derën zërave të errët).
Plot e kam barkun
e i pangopur mbetem me bukuritë tua.

Andaj shkruaj,
prap shkruaj,
e prap rend i ndezur brigjeve të tua...

NËPËR QESHJEN TONË

U shkokluam duke qeshur
me njeri tjetrin.

U shkokluam duke qeshur
me vajzat e bukura.

U shkokluam duke qeshur
nëpër krahërorin e tokës.

Nëpër qeshjen tonë e di se pranverat nxjerrin
sythe,
e di se i matur duhet të hedh hapin tim,
që fjollë të shkojë qeshja e të mos grisët.

Nëpër qeshjen tonë
ndiej të rrjeshtojmë betejat e reja të stinëve,
digën të ngrihet gjithnjë më lart drejt diellit.

Nëpër qeshjen tonë
oshtima e Drinit bëhet dritë,
shikimi bëhet i përflakur dhe ngroh gjirin e
gëzimit.

Nëpër qeshjen tonë
e dimë se armikut s'i falim kurrë befasinë,
e dimë se duhemi e rritemi,
e dimë se duhet të qeshim.

B U K A

Mora bukën ta rreshk në prushin e vatrës, —
ëndrrën e gjyshit e të babës më dukej se prekja;
herë ngjyhej në gjak,
herë në djersë pikonte,
herë buzëqeshte tërë shëndet.

Bukën rrotullova në vatër për ta nxehë, —
krisma të therta m'u duk se dëgjova;
frëngjitë sikur hapën flegrat tërë inat,
ara mbeti vejë
e buka u dogj mbi thëngjijtë.

Mora bukën ta thyeja,
m'u duk se tërë hapësirat jehuan gjerë e gjatë:
«Respekt, biri ynë, për të respekt!».

A T Ë N A T Ë

«Po biro. Ne e dinim si njeri të shenjtë. Por nata fëmijën e padre Zefit e të murgeshës e treti në ujërat e bardha të lumit...».

(Nga tregimet gojore të vitit 1967)

Atë natë hëna thyhej në ujrat e lumit,
majë kodre kryqi thyente horizontin blu.
Atë natë nënë Dila i lutej zonjës për shëndetin e
fëmijve.
Në bodrumet e kishës lyheshin duart me currila
gjaku, me nota krimi.
Atë natë ujërat e bardha lëpinin shkëmbenjtë e
ftohur nën kupën e qiellit të xixëllimtë.
Brigjeve të hirta afrohej thes i lyer me gjakun e
rimtë.
Atë natë shpellat lëpinin vetminë e tyre,
padre Zefi vogëlushin e gjakosur lëshonte nëpër
valë.
Atë natë Dila i lutej zotit për shëndetin e fëmijve,

«i dërguari i zotit» kthjelltësinë e lumit kishte
prishur.

Atë natë «amini» i shfaqej nënë Dilës në gjumë,
thes i gjakosur përplasej e nxirrte shkumë.

D Ē G J O N I

I dēgjoni?

Bien borie, tambure, sirena lirie;
gjakrat ziejnē e derdhen betejave,
iderat shigjetohen, kacafyten, ca vdesin e ca
ngrihen.

Xhunglat zhuriten, përflaken, buçasin në
shpagim.

Bota thërret e prushur.
I dēgjoni!

Prova,
nën dhe e mbi dhe,
në kurriz të popujve,
mbi gryka topash degë ullinjsh botën hutojnë.

Dëgjoni!

A e dëgjoni Enverin në sheshin «Skënderbej»
çdo fjalë flamur, përjetësi drejtësie!

Dëgjoni!

A i dëgjoni

hovet e njerëzisë?!

KUOTA KATËRQIND MIJË¹⁾ — FIERZË

Kur të jetë ndërtuar hidrocentrali

Njerëzit zënë e qeshin,
qeshin si vetja e tyre.

Shkëmbenjtë të mrrolur²⁾ e të thatë mbeten,
çahen e coptohen e syçelur mbeten,

Njerëzit zenë e qeshin,
qeshin si vetja e tyre.

Ujërat rrëshqasin plot poterë e llokoçitje,
ëndërra e dëshira, gjithë ç'kanë, i marrin në
vojitje.

Njerëzit përsëri qeshin,
qeshin si vetja e tyre.

1) Fuqia e instaluar e hidrocentralit të Fierzës do të jetë 400 mijë kilovat.

2) i mrrolur — i vrenjtur.

Zhavori lëpin buzët e kovës,
kariëra e tij mbaron në kuotën 160 m.
Njerëzit më shumë qeshin,
qeshin si vetja e tyre.

Uji rrëzohet me poterë në kuotën zero
e dritat qeshin si njerëzit në kuotën katërqind
mijë.

Njerëzit qeshin e qeshin,
qeshin në kuotën katërqind mijë.

A MOS ERDHE?

A mos erdhe me gjallërimin e qershorit
e më leve sytë me ngjyrën e pasionit?
A mos erdhe kur dashuria shtetiste remave të
zemrës
e rrëmbeve me vete tërë madhështinë e mbrëmjes?

Ç'ndodhi vallë
që tek unë hyre pa ditur se po vjen?!
Veç re drejt e në shpirt,
thellë e në gjak
e u ngjite,
një me mua u bëre
kantjereve të Shqipërisë!

A mos erdhe kur pranvera edhe yjet i ndizte në
dashuri,
apo thjesht e thjesht mes punës,
re tek unë
ti, o poezi?!

Ti ke ardhur,
e kudo me vete të kemi për revolucionin tek
punojmë
e prap të pyes:
«A mos erdhe?!»

KËNGA NË BJESHKË

E zuri këngën nata e verës në rudinë.
Mbi të ra vesa e ngjyer me dritë hëne.

M'i dolën këngës dy vajza në rrugë,
e sollën nëpër sy duke e ngrohur e zbuluar,
e kënga shkrep më shkrep iku e ndezur, —
kënga u kall¹⁾ e mbeti pa fjetur.

Me këngën rendën turma e zogjve
e në cicërimë zbritën tek Rrasa e Alisë;
atje kënga ra në prehrin e bareshës
e iu vesh shpatinave
me njëmijë ngjyra lulesh,
me njëmijë parada cicërimash.

1) u kall — u ndez.

D R I T A

Edhe sikur çdo llampe t'i vendosim nga një vjer-
shë,
çdo central ta rrethojmë me fije poeme,
me rima të bukura e thekse të ngjeshur,
borxhlinj ndaj dritës prapë do të mbetemi.

E djegur në ballrat tanë si një dëshirë
erdh' drita e Partisë, maleve shkrepri, —
na shtoi besimin, na rriti fuqinë
e në vatra e zemra gëzimin ndezi.

M'I RANË KËNGËS

M'i ranë këngës e në sopatë desh e çanë;
ajo më mbajti mue
e unë atë,
dot s'na ndanë.

Ç'm'i ranë këngës me fjalë
e nga jeta e ndanë:
unë u zverdha si pjepri i bërë.

Ajo u dremit
një «oh» zemre, në pellgun e lotëve duke lënë.

Vallë çfarë tjetër
më të madhe,
më të ëmbël
se sa jetën
në fluturimin e hapsirave mund të gjejmë?!

M'i ranë këngës top pambuku tërë sheqer
e unë u kalamenda, —
kënga u zbeh e gati ra.

Dielli shkëlqeu në horizontin e qartë.
E në jetë derdha prapë djersë e mund:
e kënga u rrit e begatë, e begatë!

PASQYRA E LËNDËS

	Faqe
Po vij	3
Në Fierzë	7
Dëshira e bujkut	8
Ç'm'i mori malli	10
Kostarët	12
Mes dashurisë	14
Baresha	15
Bardhësi	17
Bjeshkët në auditor	18
Gozhda e vjetër	19
Asim Vokshit	21
Ku është pranvera	22
Bjeshka ime kufitare	23
Biseda e shpateve	25
Bjeshkëve tona	28
Dasma	29
Partia	30
Shkruaja letrën vëllait	32
Në sytë e mi u ndezët	33
Prekëm	34
Duke shkruar	35
Nëpër ara	36
Fëminia ime	37
Socializmi	39
Për shokët që shtruan sofrën e agimeve	41

I pangopur	44
Nëpër qeshjen tonë	46
Nënë	48
Buka	49
Atë natë	50
Dëgjoni	52
Kuota katërqind mijë — Fierzë	54
A mos erdhe?	56
Kënga në bjeshkë	58
Drita	59
M'i ranë këngës	60

Redaktuar nga: Ramazan Vozga

Kopertina nga: Svetllana Strazimiri

Tirazhi 1.500 kopje Format 70x100/32 Stash: 2204-72

Shtyp. Drejtoria Qendrore Poligrafike
Shtypshkronja «8 NËNTORI» — Tiranë, 1974